



# **Raporti vjetor i KW4W**

## **2020**

## Hyrje

Gjatë vitit K-W4W ka vazhduar me fuqizimin social dhe ekonomik të grave sipas objektivave të Strategjisë së organizatës 2017-2021, në zhvillimin individual të grave, përkrahjen për rrjetëzim dhe grupe si dhe bizneset e grave. Përkundër një viti jashtëzakonisht sfidues për shkak të pandemisë së Covid19 për punë dhe implementimin e aktiviteteve në teren, janë arritur pothuajse të gjitha rezultatet e parapara duke u adaptuar për punë nga shtëpia dhe organizimin e trajnimeve online si dhe vazhdimin të rregullt të punës sapo janë krijuar mundësitë.

Një letër informuese është përgaditur dhe shpërndarë për punën gjatë karantinës dhe këtu po i përmendim shkurt të dhënat e kësaj periudhe: me 165 gra të organizuara në grupe është komunikuar rregullisht përmes Viber-it dhe Zoom-it, me 120 gra janë organizuar debate rreth të drejtës në pronë, 33 gra kanë marrë pjesë në trajnimet profesionale përmes takimeve online, 55 biznese kanë marrë pjesë në trajnimet online, 45 gra janë udhëzuar në prodhimin e punëdoreve dhe 135 gra kanë marrë pjesë në intervistat për monitorim dhe vlerësim.

Mbajtja e trajnimeve, dhënja e incentivave/inputeve, dhënja e granteve, fasiliteti i punësimit, projektet e avokimit në fusha të ndryshme, ngritja e kapaciteteve të bizneseve dhe shoqatave janë puna e zhvilluar me përfitueset e projekteve të ndryshme. Numri i grave me të cilat kemi punuar gjatë vitit është 1372, prej tyre 75 biznese, ndërsa numri i grave të punësuar është 89.

Për herë të parë kemi përfshirë fëmijët e pjesëmarrëseve të projektit për avokim për të drejtat e grave në pronë në debatet e përbashkëta, për të edukuar fëmijët për këtë çështje nga perspektiva e barazisë gjinore.

Më poshtë janë të prezentuara projektet të cilët janë implementuar gjatë këtij viti:

### Projekti: Women's Opportunities in Market, Economy and Networking (WOMEN)/ Mundësitë për gratë në treg, ekonomi dhe rrjetëzim

<b>Donatori i projektit:</b>	GIZ
<b>Data e fillimit dhe mbarimit të projektit:</b>	01.06.2018 – 31.12.2020
<b>Buxheti:</b>	446,827.97 EUR

<b>Qëllimi/Objektivat e përgjithshme të projektit</b>	Objektivi kryesor i projektit është të kontribuojë në rritjen e bizneseve dhe qëndrueshmërinë e bizneseve në pronësi dhe bashkëpronësi të grave dhe të mundësojë punësimin e rreth 150 grave
<b>Objektivat specifike të projektit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nismat e grave dhe bizneset në pronësi dhe bashkëpronësi kanë kapacitete për të funksionuar si biznese stabile dhe të suksesshme që mbështesin dhe punësojnë gra të tjera</li> <li>• Është inicuar dhe promovuar marka Biznesi në Pronësi të Grave (WOB) për të mbështetur gratë në ekonomi</li> <li>• Vendoset bashkëpunimi midis bizneseve në pronësi të grave, bizneseve që punësojnë kryesisht gra dhe grupeve të zyrtarizuara të grave për të mësuar, koordinuar dhe kohezion</li> <li>• Një OJQ ka ndërtuar kapacitetet e saj duke u përfshirë në aktivitete të projektit dhe duke mësuar nga aktivitetet e KW4W për ngritje të kapaciteteve</li> <li>• Grante të drejtpërdrejta për start-up ide ose biznese të vogla lokale. Grantet do të përqendrohen në ide të reja inovative, punësimin, zgjerimin e produkteve dhe shërbimeve, promovimin dhe marketingun dhe mikro-infrastrukturën. Në këtë mënyrë, grante të drejtpërdrejta u ofrohen hisedarëve lokal të ideve inovative për start-up, në mënyrë që jo vetëm të mbështesin dy aktivitete të mëparshme, por gjithashtu të mbështesin drejtpërdrejt aktivitetet e tyre biznese dhe organizative dhe të gjenerojnë më shumë punë</li> </ul>
<b>Nr. i përfitueseve</b>	125

## Projekti: "Crafting Lives"/ Thurrja e jetëve

<b>Donatori i projektit:</b>	BMZ -GIZ
<b>Data e fillimit dhe mbarimit të projektit:</b>	17.12.2017-15.06.2020
<b>Buxheti:</b>	248,570 EUR
<b>Qëllimi/Objektivat e përgjithshme të projektit</b>	Objektivi kryesor i projektit është të kontribuojë në përmirësimin e jetesës dhe stabilitetin ekonomik për gratë e kthyer në Kosovë dhe familjet e tyre , dhe për ato gra me potencial migrimi.
<b>Objektivat specifike të projektit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 200 gra të kthyer dhe me potencial migrimi kanë zhvilluar aftësitë e tyre profesionale në një nga trajnimet profesionale KW4W (Rrobaqepësi dhe Kujdesi për fëmijë)</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 100 gra të kthyer dhe me potencial migrimi kanë mësuar teknika të reja artizanale dhe 10 prej tyre kanë mësuar gjithashtu teknikën e ngjyrsojes Batik.</li> <li>• 100 gra të trajnuara në trajnime profesionale më lart kanë marrë trajnime shtesë për aftësi të buta për t'i përgatitur ato më tej për tregun e punës</li> <li>• Zyra Për Punësim në kuadër të KW4W ka lehtësuar punësimin e grave të kthyer.</li> <li>• Gratë e trajnuara vetëpunësohen duke prodhuar dhe shitur prodhimet e tyre artizanale</li> <li>• Punimet artizanale të grave promovohen në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar përmes dyqanit online Balkanspring.</li> </ul>
<b>Nr. i përfitueseve në vitin 2020</b>	67

**Projekti: SEE Viti 'Improved Self-Employment & Employment opportunities in Viti'/ Mundësitë e përmirësuara për punësim dhe vetëpunësim në Viti**

<b>Donatori i projektit:</b>	UNDP
<b>Data e fillimit dhe mbarimit të projektit:</b>	18.10.2019 – 31.08. 2020
<b>Buxheti:</b>	29,442.54 EUR
<b>Qëllimi/Objektivat e përgjithshme të projektit</b>	Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në rritjen e mundësive të punësimit dhe vetë-punësimit për të rinjtë dhe gratë në komunën e Vitisë
<b>Objektivat specifike të projektit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbështetje për gratë dhe burrat e rinj për çasje në informacion dhe mundësi për punësim dhe vetëpunësim</li> <li>• Zhvillimi i aftësive profesionale dhe të buta për 200 gra dhe burra të rinj për t'i bërë ata të gatshëm për punë dhe për të rritur shanset e tyre për punësim dhe vetëpunësim</li> </ul>
<b>Nr. i përfitueseve në vitin 2020</b>	200

**Projekti: Integrated Social and Economic Empowerment for Marginalized Women in Kosovo/ Fuqizimi i integruar social dhe ekonomik i grave të marginalizuara në Kosovë**

<b>Donatori i projektit:</b>	Cartier Foundation
<b>Data e fillimit dhe mbarimit të projektit:</b>	09.2017 -09.2020
<b>Buxheti:</b>	298,844 \$
<b>Qëllimi/Objektivat e përgjithshme të projektit</b>	Mirëqenia dhe jetesa e 450 grave në Kosovë janë përmirësuar
<b>Objektivat specifike të projektit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 450 gra në Kosovë kanë përmirësuar vetëbesimin, njohuritë për të drejtat dhe shëndetin, dhe kanë ndikuar në vendimmarrje</li> <li>• 450 gra kanë rritur kursimet dhe kanë përmirësuar aftësinë për të qenë të vetë-qëndrueshme ekonomikisht</li> <li>• 450 gra të diplomuara në Kosovë rrisin të ardhurat e tyre përmes mbështetjes së mëtejshme për aktivitetet e tyre ekonomike</li> </ul>
<b>Nr. i përfitueseve në vitin 2020</b>	150

**Projekti: She Has Rights/ Ajo ka të drejta**

<b>Donatori i projektit:</b>	Ambasada e Shteteve të bashkuara të Amerikës në Prishtinë
<b>Data e fillimit dhe mbarimit të projektit:</b>	8. 2019 – 11. 2020
<b>Buxheti:</b>	22,010.00 USD

<b>Qëllimi/Objektivat e përgjithshme të projektit</b>	Komunat e Ferizajt, Vitisë dhe Vushtrrië kanë azhurnuar politikat e tyre që sigurojnë këshille funksional të fshatrave dhe komuniteteve brenda komunave të tyre dhe që garantojnë pjesëmarrjen e grave në këto struktura. E gjithë kjo me qëllimin përfundimtar që të ketë struktura funksionale të këshilleve të fshatrave dhe komunitetit në Kosovë dhe në të cilat përfaqësohen grate.
<b>Objektivat specifike të projektit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ekzistojnë rregullore që garantojnë funksionimin më të mirë të këshillit të fshatit dhe komunitetit dhe përfaqësimin e grave përmes një kuote gjinore deri në fund të projektit në komunat e Ferizaj, Viti dhe Vushtrri.</li> <li>• Ndërgjegjësimi dhe njohuria mes grave rurale për rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në proceset vendimmarrëse, duke filluar nga strukturat e fshatit / komunitetit, është përmirësuar deri në fund të projektit në komunat e Ferizajt, Vitisë dhe Vushtrrisë.</li> <li>• Ka filluar debat i hapur në nivelin qendror në mënyrë që të institucionalizojë rëndësinë e këshillit të fshatit/komunitetit në proceset e vendimmarrjes përmes bërjes së politikave që parashikojnë implikime të buxhetit për funksionimin e strukturave të tilla dhe depolitizimin e tyre deri në fund të projektit</li> </ul>
<b>Nr. i përfitueseve në vitin 2020</b>	300

**Projekti: Integrated Social and Economic Empowerment for Marginalized Women in Kosovo/ Fuqizimi i integruar social dhe ekonomik i grave të margjinalizuara në Kosovë**

<b>Donatori i projektit:</b>	Cartier Foundation
<b>Data e fillimit dhe mbarimit të projektit:</b>	01.12.2020 – 30.10.2023
<b>Buxheti:</b>	300,000.00 USD
<b>Qëllimi/Objektivat e përgjithshme të projektit</b>	Mirëqenia dhe qëndrueshmëria e 450 grave në Kosovë janë përmirësuar
<b>Objektivat specifike të projektit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 350 gra kanë përmirësuar vetëbesimin, njohuritë për të drejtat dhe shëndetin, dhe kanë ndikuar në vendimmarrje</li> <li>• 350 gra kanë përmirësuar mirëqenien e tyre ekonomike përmes</li> </ul>

	<p>aftësive të reja profesionale</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 350 gra të diplomuara kanë përmirësuar aftësinë për të qenë të vetë-qëndrueshme ekonomikisht përmes mbështetjes shtesë dhe qasjes së përmirësuar në treg</li> <li>• 350 gra të diplomuara janë qytetare aktive dhe të qëndrueshme nga ana sociale përmes aftësive të përmirësuara të avokimit, lidhjeve dhe rrjetëzimit</li> </ul>
<b>Nr. i përfitueseve në vitin 2020</b>	Puna me gra fillon në 2021

## Projekti: Kosova-Women 4 Women Core Support for 2020/ Përkrahja për 2020

<b>Donatori i projektit:</b>	Women for Women International
<b>Data e fillimit dhe mbarimit të projektit:</b>	01.01. 2020 – 31.12.2020
<b>Buxheti:</b>	50,000 USD
<b>Qëllimi/Objektivat e përgjithshme të projektit</b>	Fuqizim i integruar social dhe ekonomik për gratë e marginalizuara në Kosovë
<b>Objektivat specifike të projektit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 60 gra kanë përmirësuar vetëbesimin, njohuritë për të drejtat dhe shëndetin, dhe kanë ndikuar në vendimmarrjen</li> <li>• 60 gra kanë rritur kursimet dhe përmirësuar aftësitë për të qenë të vetë-qëndrueshme ekonomikisht</li> <li>• 60 gra të diplomuara rrisin të ardhurat e tyre përmes mbështetjes së mëtejshme për aktivitetet e tyre ekonomike.</li> </ul>
<b>Nr. i përfitueseve në vitin 2020</b>	60

**Emri i projektit: "I SEE" - Improved Self-Employment and Employment Opportunities/ Mundësitë e pëmirësuara për vetëpunësim dhe punësim**

<b>Donatori i projektit:</b>	Austrian Development Agency - ADA
<b>Data e fillimit dhe mbarimit të projektit:</b>	01.11. 2019 – 31.10. 2022
<b>Buxheti:</b>	555,692.00 EUR
<b>Qëllimi/Objektivat e përgjithshme të projektit</b>	Përmirësimi i pozitës së grave në ekonomi dhe tregun e punës
<b>Objektivat specifike të projektit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 300 gra janë pajisur me aftës profesionale, të buta dhe afariste, të nevojshme për punësimin dhe vetëpunësimin e tyre</li> <li>• Shërbimet e Zyrës Për Punësim janë azhurnuar dhe ka zgjeruar funksionimin e saj në regjionin e Ferizajt</li> <li>• Gratë kanë qasje në burime dhe mundësi për financa</li> <li>• 10 gra sipërmarrëse të reja janë vendosur në Inkubatorin e Biznesit të Grave, duke përfituar nga start-up dhe aktivitetet për zhvillimin e kapaciteteve.</li> </ul>
<b>Nr. i përfitueseve në vitin 2020</b>	47

**Emri i projektit: "Stand for her property"/Mbroje të drejtën tënde**

<b>Donatori i projektit:</b>	ATRC
<b>Data e fillimit dhe mbarimit të projektit:</b>	15.07. 2019 – 15.09. 2022
<b>Buxheti:</b>	56.114 USD
<b>Qëllimi/Objektivat e përgjithshme të projektit</b>	Qëllimi i projektit është të rrisë ndërgjegjësimin ndër gra dhe fëmijë mbi pronën e grave dhe të drejtat e trashëgimisë dhe t'i fuqizojë gratë të kërkojnë atë të drejtë.
<b>Objektivat specifike të projektit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ngritja e ndërgjegjësimit të 200 grave në të gjithë Kosovën për të drejtat e tyre në pronë dhe trashëgimi sipas legjislacionit aktual dhe Strategjisë</li> </ul>



	<p>Kombëtare për të drejtat e pronës; dhe mbi mundësitë dhe shërbimet për të kërkuar atë të drejtë</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Edukimi i 250 fëmijëve dhe të rinjëve të moshës 14-22 ~ së bashku me 150 gra/nëna në të gjithë Kosovën për të drejtat e pronës nga perspektiva e barazisë gjinore dhe rolet gjinore në diskutimet e përbashkëta me nënat e tyre</li> <li>• Stimulimi i iniciativës së grave për të kërkuar pronën dhe të drejtat e trashëgimisë përmes fuqizimit të tyre ekonomik dhe qasjes në ndihmë juridike falas</li> </ul>
<p><b>Nr. i përfitueseve në vitin 2020</b></p>	<p>423</p>